L I G J
Nr.9478, datë 16.2.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË VENDIMET II/14 DHE III/7, AMENDAMENTE TË KONVENTËS SË ESPOO-S "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS, NË KONTEKST NDËRKUFITAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në vendimin II/14, amendament i Konventës së ESPOO-s "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar".

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në vendimin III/7, amendament i Konventës së ESPOO-s "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4800, datë 10.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

SHTOJCA VII
VENDIMI III/7
AMENDAMENTI I DYTË I KONVENTËS SË ESPOO-S

Mbledhja,

duke mbajtur parasysh vendimin e saj 11/10 mbi rishikimin e Konventës dhe paragrafin 19 të Deklaratës Ministeriale të Sofies;

duke dëshiruar të ndryshojë Konventën me synim forcimin e mëtejshëm të zbatimit të saj dhe përmirësimin e raportit me marrëveshjet e tjera shumëpalëshe mjedisore;

duke përgëzuar punën e bërë nga grupi i punës i krijuar në mbledhjen e dytë të palëve, nga grupi i vogël mbi ndryshimet dhe nga vetë grupi i punës mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis;

duke vënë në dukje Konventën për të drejtën për informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin, bërë në Aarhus, Danimarkë, më 25 qershor 1998, dhe duke mbajtur parasysh Protokollin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, bërë në Kiev, Ukrainë, më 21 maj 2003;

gjithashtu duke vënë në dukje instrumentet ligjore përkatëse të Komunitetit Europian, si direktiva 85/337/EEC e 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin, të ndryshuar nga direktiva 97/11/EC dhe 2003/35/EC;

e ndërgjegjshme që një zgjerim i shtojcës I do të forcojë në rajon rëndësinë e vlerësimeve të ndikimit në mjedis;

duke njohur përfitimet e bashkëpunimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur në vlerësimin e ndikimit në mjedis;

duke inkurajuar punën e Komitetit Zbatues si një mjet i dobishëm për zbatimin e mëtejshëm dhe aplikimin e dispozitave të Konventës:

1. Konfirmon që vlefshmëria e vendimeve të marra para hyrjes në fuqi të amendamentit të dytë të Konventës, duke përfshirë adoptimin e protokolleve, krijimin e organizmave mbështetës, rishikimin e përshtatshmërisë dhe veprimeve të marra nga Komiteti Zbatues, nuk ndikohen nga adoptimi dhe hyrja në fuqi e këtij amendamenti.

2. Gjithashtu konfirmon që secila palë vazhdon të jetë e përshtatshme të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet në bazë të Konventës, duke përfshirë përgatitjen e protokolleve, krijimin dhe pjesëmarrjen në organizmat mbështetës, dhe shqyrtimin e respektimit, pavarësisht nëse amendamenti i dytë i Konventës ka hyrë në fuqi apo jo për atë palë.

3. Adopton amendamentet e mëposhtme të Konventës:

a) Në nenin 2, pas paragrafit 10, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

11. Nëse pala iniciatore synon të kryejë një procedurë me qëllimin e caktimit të përmbajtjes së dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, palës së interesuar, në masën e duhur, duhet t'i krijohet mundësia për të marrë pjesë në këtë procedurë.

b) Në nenin 8, pas Konventës futet

dhe në bazë të çdo protokolli të saj në të cilin ato janë palë.

c) Në nenin 11, zëvendësohet paragrafi 2(c) nga një nënparagraf i ri me këtë formulim:

c) Kërkojnë, sipas rastit, shërbimet dhe bashkëpunimin e organeve kompetente që kanë ekspertizën që lidhet me arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente;

d) Në fund të nenit 11, futen dy nënparagrafë me këtë formulim:

g) Përgatisin, sipas rastit, protokollet e kësaj Konvente;

h) Krijojnë organizma të tillë mbështetës që konsiderohen të nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.

e) Në nenin 14 paragrafi 4 zëvendësohet fjalia e dytë me një fjali të re me këtë formulim:

Ato hyjnë në fuqi për palët që i kanë ratifikuar, miratuar ose pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas marrjes nga depozituesi të njoftimit për ratifikimin, pranimin ose miratimin e tyre nga të paktën tre të katërtat e numrit të palëve në kohën e adoptimit të tyre.

f) Pas nenit 14, futet një nen i ri me këtë formulim:

Neni 14 bis

Shqyrtimi i respektimit

1. Palët rishikojnë respektimin e dispozitave të kësaj Konvente në bazë të procedurës së respektimit, si një procedurë joakuzatore dhe e orientuar drejt ndihmesës, e miratuar nga mbledhja e palëve. Shqyrtimi bazohet mbi, por nuk kufizohet nga raportimi i rregullt nga ana e palëve. Mbledhja e palëve vendos mbi shpeshtësinë e raportimit të rregullt të kërkuar nga palët dhe informacionin që duhet të përfshihet në ato raporte të rregullta.

2. Procedura e respektimit duhet të jetë e përshtatshme për zbatimin e çdo protokolli të adoptuar në bazë të kësaj Konvente.

g) Zëvendësohet shtojca I e Konventës nga shtojca e këtij vendimi.

h) Në shtojcën VI, pas paragrafit 2, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

3. Paragrafët 1 dhe 2 mund të zbatohen, *mutatis mutandis* për çdo protokoll të Konventës.

SHTOJCA

LISTA E AKTIVITETEVE

1. Rafineri të naftës bruto (duke përjashtuar sipërmarrje për prodhimin e lubrifikanteve nga nafta bruto) dhe instalime për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve metrikë ose më tepër qymyr ose rërë bituminoze në ditë.

2. a) Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie prej 300 megawat ose më shumë, dhe

b) Stacione bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë duke përfshirë çmontimin dhe heqjen nga funksionimi të këtyre stacioneve dhe reaktorëve bërthamorë 1 (duke përjashtuar impiantet kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e materialeve të ndashme ose ushqyese, fuqia maksimale e të cilëve nuk i kalon 1 kilowat ngarkesë termike të vazhdueshme).

3. a) Instalime për ripërpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar.

b) Instalime të projektuara:

- Për prodhimin dhe pasurimin e karburantit bërthamor;

- Për përpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiviteti;

- Për depozitimin përfundimtar të karburantit bërthamor të rrezatuar;

- Vetëm për depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;

- Vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më shumë se 10 vjet) të karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjes radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.

4. Instalime të mëdha për shkrirjen fillestare të gizës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbajtje hekuri.

5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e asbest-çimentos, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20 000 tonë metrikë produkt përfundimtar; për materiale fërkimi, me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë metrikë produkt përfundimtar dhe për përdorimin e llojeve të tjera të asbestit për më shumë se 200 tonë metrikë në vit.

6. Instalime kimike të integruara.

7.a) Ndërtimi i autostradave, rrugëve të shpejtësisë 2/ dhe linjave të distancave të gjata të trafikut hekurudhor dhe të aeroporteve 3/ me pistë bazë (ngritje-ulje) prej 2100 metra ose më tepër.

b) Ndërtimi i një rruge të re me katër korsi ose më shumë, ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak korsi për të siguruar katër ose më shumë korsi ku kjo rrugë e re ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i seksionit të rrugës do të jetë 10 km ose më shumë në gjatësi të vazhduar.

8. Tubacionet me diametër të madh për transportimin e naftës, gazit ose kimikateve.

9. Portet tregtare dhe gjithashtu rrugët ujore të brendshme dhe portet për trafikun ujor të brendshëm që lejojnë kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 tonë metrikë.

10. a) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie, trajtim kimik ose groposje për mbetje toksike dhe të rrezikshme.

b) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie ose trajtim kimik të mbetjeve të parrezikshme me kapacitet mbi 100 ton metrikë në ditë.

11. Diga dhe rezervuarë të mëdhenj.

12. Aktivitetet e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ku vëllimi vjetor i sasive të ujërave të nxjerra ose të ringarkuara është 10 milionë m^3 ose më shumë.

13. Prodhimi i letrës, brumit të letrës dhe kartonit me kapacitet 200 tonë metrikë në ditë ose më shumë, i tharë me ajër.

14. Miniera dhe kariera (gurore) të mëdha, nxjerrja dhe përpunimi në vend i mineraleve metalike ose qymyrit.

15. Prodhimi i hidrokarbureve në det. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare ku sasia e nxjerrë kalon 500 tonë metrikë në ditë në rastin e naftës dhe 500 000 m^3 në ditë në rastin e gazit.

16. Impiante të mëdha për ruajtjen e naftës, produkteve petrokimike dhe kimike.

17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.

18. a) Punime për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve të lumenjve, ku transferimi synon parandalimin e pakësimit të ujërave, dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 100 milionë m^3 në vit;

b) Në të gjitha rastet e tjera, punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se 2000 milionë m^3 në vit dhe ku sasia e ujit të transferuar është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.

19. Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet që e kalon ekuivalentin e një popullsie 150 000 banorë.

20. Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave që kanë më shumë se:

a) 85 000 vende për zogj;

b) 60 000 vende për pula;

c) 3000 vende për derra (mbi 30 kg);

d) 900 vende për dosa.

21. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë me një tension 220 kV ose më shumë dhe një gjatësi prej më shumë se 15 km.

22. Instalime të mëdha për shfrytëzimin e kombinuar të fuqisë së erës për prodhim energjie (fermat e erës).

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, stacionet e fuqisë bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë pushojnë së qeni instalime të tilla kur gjithë karburanti bërthamor dhe elementet e tjera të ndotura radioaktive janë zhvendosur përfundimisht nga vendi i instalimit.

2. Për qëllime të kësaj Konvente:

"Autostradë" është një rrugë e projektuar dhe e ndërtuar për trafik automobilistik, e cila nuk u shërben zonave përreth, dhe e cila:

a) Është e pajisur, me përjashtim të pikave të veçanta ose përkohësisht, me karrexhata të ndara për të dy drejtimet e trafikut, të ndara nga njëra-tjetra nga një vijë ndarëse që nuk shkelet nga trafiku, ose në raste të rralla, me mjete të tjera;

b) Nuk ndërpritet në të njëjtin nivel nga ndonjë rrugë, shinë hekurudhe ose tramvaji apo rrugë këmbësorësh;

c) Është e sinjalizuar në mënyrë të veçantë si autostradë.

"Rrugë shpejtësie" është një rrugë e rezervuar për trafik makinash ku hyrja mund të bëhet vetëm nga kryqëzimet në disnivel ose kryqëzimet e kontrolluara dhe në të cilën veçanërisht ndalimi dhe parkimi janë të ndaluara përgjatë karrexhatave të lëvizjes.

3. Për qëllime të kësaj Konvente, "aeroport" do të thotë një aeroport që është në pajtim me përkufizimin e Konventës së (Çikagos të vitit 1944 për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).

Vërtetoj se teksti i mësipërm është një kopje origjinale e amendamentit të miratuar më 4 qershor 2004 në mbledhjen e tretë të palëve në Konventën mbi vlerësimin e ndikimit në ambient në një kontekst ndërkufitar, që u mbajt në Cavtat, Kroaci, nga data 1 deri 4 qershor 2004.

Për Sekretarin e Përgjithshëm
Këshilltari Ligjor
(Nënsekretarin e Përgjithshëm për Çështjet Ligjore)

Organizata e Kombeve të Bashkuara, New York
10 nëntor 2004

VENDIMI II/14
AMENDAMENTI I KONVENTËS SË ESPOO-S

Mbledhja,

me dëshirën për të ndryshuar Konventën ESPOO me qëllim që të sqarohet që publiku që mund të marrë pjesë në procedura, në bazë të kësaj Konvente, përfshin shoqërinë civile dhe veçanërisht organizatat joqeveritare;

duke vënë në dukje paragrafin 13 të Deklaratës së Oslos të ministrave të ambientit dhe

komisionerit të Komunitetit Europian për ambientin të mbledhur në Oslo me rastin e mbledhjes së parë të palëve në Konventën ESPOO;

me dëshirën për të lejuar shtetet që ndodhen jashtë rajonit UN/ECE të bëhen palë në Konventë,

adopton amendamentet e mëposhtme të Konventës:

a) Në fund të nenit 1(x) pas personave futet

dhe në pajtim me legjislacionin ose praktikën e brendshme, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre.

b) Në nenin 17, pas paragrafit 2, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

3. Çdo shtet tjetër që nuk është përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe që është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Konventë me miratimin e mbledhjes së palëve. Mbledhja e palëve nuk merr në shqyrtim apo aprovon asnjë kërkesë për aderim nga një shtet i tillë, derisa ky paragraf nuk ka hyrë në fuqi për të gjitha shtetet dhe organizatat që ishin palë në Konventë më 27 shkurt 2001.

Dhe numrat e paragrafëve të tjerë ndryshohen përkatësisht.

c) Në fund të nenit 17, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

7. Çdo shtet apo organizatë që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë konsiderohet të ketë ratifikuar, pranuar apo aprovuar njëkohësisht amendamentin e Konventës, të caktuar në vendimin II/14 të marrë në mbledhjen e dytë të palëve.